

Kryetari i Komunës së Ulqinit, me vendim numër 01 –277/19-3 të dates 02.03.2023 ka konfirmuar Ndryshimet dhe plotësimet për Projekt planin për objektet e përkohshme në territorin e Komunës së Ulqinit për vitin 2019-2023, si dhe ka obliguar Sekretariatit për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm që të realizojë shqyrtimin publik.

Projekti del në:

## SHQYRTIM PUBLIK

Me rastin e Ndryshimeve dhe plotësimeve të projekt planit për objektet e përkohshme Sekretariati për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm i Komunës së Ulqinit organizon dhe realizon shqyrtimin publik, i cili do të zgjasë 15 ditë.

Shqyrtimi publik i Ndryshimeve dhe plotësimeve të projekt planit do të zgjasë prej datës 07.03.2023 deri më 21.04.2023.

Ndryshimet dhe plotësimet e projekt Planit do të publikohen në ueb sajtin e Komunës së Ulqinit: [www.opstinaulcinj.com](http://www.opstinaulcinj.com)

Qasja publike në Ndryshimet dhe plotësimet e projekt Planit mund të bëhet në ambientet e Sekretariatit për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm, çdo ditë pune prej orës 11:00 deri në orën 13:00.

Shqyrtimi qëndror publik për Ndryshimet dhe plotësimet e projekt Planit do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Ulqinit, të premtën, më 17.03.2023 duke filluar:

në ora 13,00 – Ndryshimet dhe plotësimet e projekt Planit të objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Ulqinit për vitin 2019-2023.

Vërejtjet, propozimet dhe sygjerimet dorëzohen me shkrim në adresën:

Sekretariati për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm i Komunës së Ulqinit, ose në e-mail: [urbanizam.ul@t-com.me](mailto:urbanizam.ul@t-com.me), deri më datë 21.03.2023.

Sekretariati për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm i Komunës së Ulqinit do t'i shqyrtojë vërejtjet, propozimet dhe sygjerimet e pjesëmarrësve në shqyrtimin publik, pas të cilit do të hartojë raporte të veçanta për shqyrtimin e realizuar publik, i cili do të jetë pjesë përbërëse e materialit për mbledhjen e Kuvendit.

Numër: 05-082/23-152/A

Ulqin, më

U. D. SEKRETARIT  
Shkelzen Sulajmani, inxh.dipl.

